



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I MINISTRAVE

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 16.03.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“FABRIKË PËR PRODHIMIN E TRANSFORMATORËVE TM, TU DHE REMONTIN E
TRANSFORMATORËVE TË FUQISË DERI NË 110 KW DHE AMBIENTE
MAGAZINIMI”, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shqiptarë “Elektroinvest” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Fabrikë për prodhimin e transformatorëve TM, TU dhe remontin e transformatorëve të fuqisë deri në 110 KW dhe ambiente magazinimi”, Bashkia Elbasan”, me subjekt zhvillues shqiptarë “Elektroinvest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëdhjet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislationit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - b) pagesës përkatëse të takses së ndikimit në infrastrukturë për llogarit të Bashkisë Elbasan.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ANËTAR / SEKRETAR I KKT



BEINDA BALLUKU

MINISTER I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË

MINISTER I LINJËS